



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0355

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim -kryetare, Isa Hasani anëtar, Vedat Poterqoi duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Dizinfekta NRG SH.P.K” me seli në Prishtinë kundër Vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit – Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit: "616-24-2103-2-1-1", me 02/07/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e “Dizinfekta NRG SH.P.K” me nr. 2024/355 , e datës 24.04.2024 lidhur me aktivitetin e “34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit: "616-24-2103-2-1-1" iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Kuvendi i Komunës së Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, kurse Ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimi të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthimin e mjeteve sipas 31 paragrafi 6, të Rregullores për Punën e OSHP, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 08.03.2024, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit: "616-24-2103-2-1-1".

Me 15.04.2024, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Me 09.04.2024, OE Dizinfekta NRG SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 15.04.2024.

Me 24.04.2024, Dizinfekta NRG SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokollit 2024/0355, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për anulim të aktivitetit të prokurimit.

- Me rastin e shqyrtimit paraprak -

Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtoj ankesë në OSHP, pas udhëheqjes së procedurës paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bie nën kompetencat e këtij organi, kuptim të nenit 105 të LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues në OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore. Lidhur me këtë, me 21.05.2024, Ekspertit Shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa të refuzohet si e pabazuar
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i cituar si më sipër i ekspertit shqyrtues është pranuar në mënyrë të rregullt nga të gjitha palët me ç'rast AK është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit lidhur me raportin në rastin konkret. Duke ju referuar të gjitha shkresave të kësaj lënde dhe provave në dispozicion të cilat janë ofruar nga palët dhe eksperti shqyrtues i prokurimit, Paneli konsideroi se nuk ka nevojë të mbahet seanca publike me palë, meqë faktet dhe provat në dispozicion ofrojnë informacione të mjaftueshme për ta vlerësuar në mënyrë meritore çështjen në rastin konkret, konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP.

Lidhur me këtë, Paneli paraprakisht konstatoi se:

· Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negociuar dhe kufizuar lloji i kontratës – punë, furnizim dhe shpërblim vlera e parashikuar e kontratës: 900,000.00 euro.

· Ankuesi ka pohuar se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7, 9, 10, 24, 27, 28, 51, 52, 62 dhe 69 të LPP-së, si dhe të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik neni 17 dhe 19 duke pezulluar aktivitetin e prokurimit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Eksperti Shqyrtues ka vlerësuar se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues lidhur me shkeljen e dispozitave ligjore, ku në pretendimin numër I, OE pretendon se AK me rastin e pranimit të kërkesës për rishqyrtim me datë 09.04.2024 nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit deri me datë 15.04.2024 ku AK ka bërë shkelje të nenit 108/A paragrafi 2 duke mos publikuar njoftimin për pezullim në aktivitetin e prokurimit, ndërsa tek pretendimi numër II, OE pretendon se me anulimin e këtij aktiviteti mund të shkaktohen dëme të mëdha, eksperti shqyrtues ka vlerësuar që ky pretendim ankimorë dhe kërkesa e OE ankues që të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit është i pabazuar dhe te pretendimi numër III, OE pretendon se pajisjet UVL duhet të hiqen si kërkesë apo të lejohen edhe pajisjet me volum normal, eksperti nuk ka mundur të rekomandoj

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se shpjegimet e dhëna në raportin e ekspertizës (pa nevojë që të gjitha ato sërish të përshkruhen dhe të komentohen) janë të arsyeshme dhe të mjaftueshme lidhur me krijimin e gjykimit në këtë rast, se ankesa është pjesërisht e bazuar.

- Përfundim -

AK gjatë zbatimit të dispozitave të LPP dhe legjislacionit dytësor gjithmonë duhet të bazohet edhe në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, që të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Ndonëse raporti i ekspertizës, dhe rekomandimet që i përmban nuk përbejnë detyrim as për palët e as për OSHP-në, në çdo rast Panelet Shqyrtuese e vlerësojnë dhe analizojnë karakterin e tyre dokumentues, në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të një lënde dhe administrimit të provave. Paneli shqyrtues vlerëson se veprimet e AK nuk janë në harmoni mes tjerash edhe me

nenin 62 paragrafi 2.2 (Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit).

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankuese se AK me rastin e pranimit të kërkesës për rishqyrtim me datë 09.04.2024 nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit deri me datë 15.04.2024 ku AK ka bërë shkelje të nenit 108/A paragrafi 2 duke mos publikuar njoftimin për pezullim në aktivitetin e prokurimit, kjo pike ankimore konsiderohet e aprovuar sepse sipas LPP-se neni 108/A, paragrafi 2 obligon që në momentin e dorëzimit të një kërkesë për rishqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht ta pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilën ka të bëjë me shkelje të pretenduar, mirëpo nëse i referohemi RPP-se 001/2022, neni 61. paragrafi 6.1 (b), kur procedurat ndërlihen me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit i mundëson AK-se për të vazhduar tutje duke respektuar kërkesat sipas nenit 63.1.1 (b).

Prandaj paneli shqyrtues, për mos planifikim të duhur të këtij aktiviteti të prokurimit, i tërheq vërejtjen AK-se, që në të ardhmen të planifikojë saktë kërkesat e një aktiviteti të prokurimit në përputhje me nenin 27 dhe 28 të LPP-se, në të kundërtën do të merren masa sipas dispozitave të LPP-se, për arsye se në këto raste dëmtohen operatorët ekonomik që kanë shprehur interes për këtë aktivitet të prokurimit.

Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe konform nenit 117 të LPP, Paneli vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi. Kurse, lidhur me tarifën ankimore, është vendosur në kuptim të nenit 31 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së, lidhur me nenin 118 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Dizinfekta NRG SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: